



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 382/3 Prot

Tiranë, më 13.5.2016

VENDIM

Nr. 23, datë 13.5.2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Ligjit Nr. 8485, datë 12.05.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit, Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik "Koço Gliozheni" Tiranë, me aktivitetin e tij në formën ligjore person juridik,

VËREJ SE :

Në zbatim të Urdhrit Nr.72, datë 18.03.2016 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për kryerjen e hetimit administrativ, më datë 12.04.2016 e në vazhdim, pranë kontrolluesit si më lart cituar filloi procedura e hetimit administrativ, me objekt kontrolli:

- Zbatimi nga ana e kontrolluesit Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik "Koço Gliozheni" Tiranë, i Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri gjatë kryerjes së aktivitetit të tij, në lidhje me masat për sigurinë e të dhënave personale, në zbatim të nenit 27 të ligjit.

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi, nga grupi i inspektimit është konstatuar:

1. Kontrolluesi nuk ka përmbushur detyrimin për informim ndaj subjekteve të të dhënave personale, mbi mbikëqyrjen e një pjese të ambjenteve të kontrolluesit me sistemin e kamerave CCTV.
2. Kontrolluesi nuk ka rregullore të veçantë për mbrojtjen e të dhënave personale, apo dhe ndonjë rubrikë ku të përcaktohen qartë detyrimet dhe të drejtat e kontrolluesit, përpunuesit dhe sidomos të subjektit të të dhënave personale-pacientit. Ka dy rregullore për mbarëvajtjen e aktivitetit të natyrës shëndetësore, të cilat na u vunë në dispozicion, por në to nuk ka asgjë të shkruar për të dhënat personale.
3. Kontrolluesi nuk ka parashikuar në kontratën me punëmarrësit, Deklaratën e Konfidencialitetit.

4. Në marrëdhëniet kontraktuale me të tretët- përpunuesit, kontrolluesi jo vetëm që nuk ka një aneks kontratë, sipas aktit nënligjor të Zyrës së Komisionerit, por në kontratë nuk ka të parashikuar as dhe një paragraf konfidencialiteti me palën tjetër.

Faktet e mësipërme, përbëjnë shkelje administrative të neneve 18, 20, 27, 28 si dhe Vendimit Nr.6, datë 05.08.2013 të Komisionerit dhe Udhëzimit Nr.19, datë 03.08.2012 të Komisionerit.

Në datë 19.04.2016, u mbajt proces verbali i konstatimit të shkeljeve për kontrolluesin *S.U.O.GJ. "Koço Gliozheni" Tiranë*, ndërmjet grupit të inspektimit dhe përfaqësuesve të kontrolluesit.

Përfaqësuesja e kontrolluesit, nuk shprehu pretendime me shkrim, pasi do i paraqiste ato në seancën dëgjimore, por u shpreh se nuk kemi patur informacion të plotë për Ligjin Nr.9887, datë 10.03.2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar.

1- Në cilësinë provës materiale, këtij procesverbali i bashkëngjiten këto dokumente:

- a-Kontratë me punëmarrësin.
- b-Kontrata bashkëpunimi (dy).
- c-Formular Njoftimi.
- d-Pamje nga ambjentet e kontrolluesit.
- e-Rregullore e Brendshme e S.U.O.GJ.-së.
- f-Statut i S.U.O.GJ.-së.

Në zbatim të neneve 93-96 të Ligjit Nr.8485, datë 12.05.1999, "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*" i ndryshuar, përpara marrjes së vendimit përfundimtar në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në datë 09.05.2016, është organizuar seanca dëgjimore me përfaqësuesit e kontrolluesit, të cilët u shprehën se pjesa më e madhe e shkeljeve të konstatuara nga grupi i inspektimit administrativ ishin rikuperuar. Pretendime të tjera nuk u ngritën por u paraqitën dokumentacione që vërtetonin përmbushjen e konstatimeve të grupit të inspektimit.

Konstatimet e gjetura konsiderohen në shkelje dhe mosrespektim të kushteve dhe kriterëve që parashikon Ligji Nr.9887, datë 10.03.2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, duke patur parasysh faktin që, kontrolluesi ka një periudhë të gjatë kohore që operon në mënyrë të paligjshme në përpunimin e të dhënave personale subjekteve të të dhënave, kryesisht pacientë.

Si përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë hetimit administrativ në kuptim të nenit 39/1 gërmat "b", "ç" dhe "dh" të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

b) kontrolluesit që nuk përmbushin detyrimin për të informuar, të përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë.

ç) kontrolluesit ose përpunuesit që nuk zbatojnë detyrimet e përcaktuara në nenin 20 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë.

dh) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë.

Kontrolluesi, Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik "Koço Gliozheni", në formën ligjore të aktivitetit të tij është person juridik dhe, sipas nenit 39/2 për kundërvajtjet e mësipërme, dënohet me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze, ato lidhen me sigurinë e të dhënave personale të pacientëve, si një e drejtë parësore e tyre dhe në zbatim të ligjit e parimeve bazë të mbrojtjes së të dhënave personale.

Komisioneri gjithashtu, ka parasysh faktin që kontrolluesi, ka bashkëpunuar dhe reaguar në rikuperimin e shkeljeve të konstatuara.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 20, 27, 28, 30, 31, 39/1, 39/2, gërmat "ç" dhe "dh", si dhe neneve 40 dhe 41 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

V E N D O S A :

1. Dënimin e kontrolluesit, Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik "Koço Gliozheni" Tiranë, me gjobë, në vlerën **100 000 (njëqind mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 20 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
2. Dënimin e kontrolluesit, Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik "Koço Gliozheni" Tiranë, me gjobë, në vlerën **100 000 (njëqind mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
3. Kontrolluesi, Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik "Koço Gliozheni" Tiranë, të realizojë aneks kontratën tip të konfidencialitetit, sipas Udhëzimit Nr.19, datë 03.08.2012 të Komisionerit, për përpunimin e të dhënave personale nga palë të treta, me të cilët kontraktin për kryerjen e shërbimeve që ata ofrojnë, e për pasojë aksesojnë të dhëna të pacientëve të kontrolluesit.
4. Kontrolluesi, Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik "Koço Gliozheni" të realizojë pajisjen e kontratave të punëmarrësve me Deklaratat e Konfidencialitetit sipas Vendimit Nr.6, datë 05.08.2013, brenda një periudhe prej 60 ditësh.

5. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e afatit të ankimit, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky vendim u shpall sot në, 13.5 .2016

Besnik DERVISHI

KOMISIONERI
